



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I39-2 Prot.
Nr. Dok. 202502736/

Tiranë 17/12/2025

Lënda: Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të pacientëve në
Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali" në Vlorë.

Drejtuar: Drejtorit të Përgjithshëm të Operatorit të Shërbimeve të
Kujdesit Shëndetësor

TIRANË

Drejtorit të Operatorit të Shërbimeve të
Kujdesit Shëndetësor Rajonal Vlorë

VLORE

Drejtori i Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë

VLORE

Për dijeni: Sekretar i Përgjithshëm
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

TIRANË

Të nderuar,

Avokati i Popullit, vlerëson bashkëpunimin e deritanishëm dhe angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona. Në vijim po ju njohim mbi inspektimin që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në institucionin tuaj në datë 08.05.2025.

Inspektimi u krye nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, dhe nenit 31 të ligjit nr. 44/2012 "Për Shëndetin Mendor", i ndryshuar, sipas Planit të Inspektimit për vitin 2025 të miratuar nga Avokati i Popullit.

Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Nertila Qafzezi dhe znj. Gloria Çarkaxhiu, me detyrë ndihmës komisionere pranë Mekanizmit Kombëtar të institucionit të Avokatit të Popullit.

Pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, Institucioni i Avokatit të Popullit ka detyrimin ligjor t'ju parashtrojë gjetjet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënime paraprake

Kjo ishte vizita periodike monitoruese e MKPT-së në Shërbimin e Psikiatrisë “Ali Mihali” në Vlorë, për vitin 2025. Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues zhvilloi takimin paraprak dhe mori një informacion të përgjithshëm nga Drejtoresha e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” në Vlorë znj. Marjola Muhaj.

Më tej, grupi i inspektimit vizitoi ambientet e këtij spitali. Nga inspektimi në vend, kontakti me stafin dhe pacientët, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, objekteve, pajisjeve dhe mjediseve, grupi inspektues grumbulloi informacion në lidhje me të drejtat, kushtet dhe trajtimin e pacientëve në këtë spital, respektimin e të drejtave të tyre, si dhe me problematikat e ndeshura gjatë punës.

Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, është strukturë spitalore e cila shtrin veprimtarinë e tij në zonën e mbulimit nga Divjaka e deri në Konsipol duke ofruar shërbim shëndetësor për shëndetin mendor për një numr prej 625,381 banorësh.

Investimi me mbështetjen e buxhetit të shtetit përfshiu transformimin në një model të ri me dy shtëpi të mbështetura, si një strukturë familjare, ku mundësohet jo vetëm trajtimi klinik, por edhe shërbime multidisiplinare, sociale dhe rekreative për banorët.

Spitali Psikiatrik Vlorë ka një **kapacitet prej 120 shtretër** dhe përbëhet nga një ekip multidisciplinar me staf mjekësor, psiko-social, mbështetës dhe administrativ prej 132 punonjës.

Spitali ofron shërbime shëndetësore për pacientët kronik në:

- ✓ Këshillime individuale
- ✓ Ergoterapi
- ✓ Psikoterapi
- ✓ Terapi grupi
- ✓ Aktivitete rehabilituese
- ✓ Aktivitete rehabilituese jashtë spitalit.

Investimi i MSHMS në Spitalin Psikiatrik Vlorë përfshiu rikonstrukcionin e Shtëpisë së Mbrojtur Gra dhe ndërtimin e godinës së re të Shtëpisë së Mbrojtur Burra me një vlerë totale prej 209,937.900 lekë me TVSH dhe kapacitet 120 shtretër:

- ✓ Mobilim dhe pajisje mjekësore në vlerë prej 22,379,400 lekë me TVSH
- ✓ Rruga e aksesit që lidh strukturat spitalore me sipërfaqe prej 360 m² asfalt dhe 43.38 m² trotuar me vlerë prej 5,021,112 lekë me TVSH.

Godina e re dykatëshe për pacientet-gra. Punimet për rikonstrukcionin e Shtëpisë së Mbrojtur Gra prej dy katesh dhe me kapacitet 60 shtretër. Rehabilitimi infrastrukturor i kësaj shtëpize përfshiu:

- Sipërfaqen totale të godinës dy katëshe prej 422.84 m² si dhe një shtesë të re prej 63.27 m². Zonën për rreth godinës me asfalt prej 350 m²
- Sipërfaqe të gjelbëruar 500 m², trotuar 143 m² dhe bordurë prej 245 ml.

Me rikonstrukcionin e plotë të strukturave funksionale për pacientet dhe personelin mjekësor, **Shtëpia e Mbrojtur Gra** përbëhet nga hyrja dhe holli kryesor, korridoret e shërbimeve, kafazi i shkallëve dhe dalje emergjence.

Në katin e parë të godinës ndodhet dhoma e Kryeinfermierit, 1 dhomë mikrokirurgji/injeksione, 1 dhomë ergoterapi, 1 dhomë psikologu, 1 dhomë punonjësi social, 1 dhomë mjeku, 1 sallë ndenjeje, 1 sallë ngrënieje si dhe 5 dhoma për banoret me nga dy shtretër.

Kati i dytë i goditës përfshin 13 dhoma pacientësh ku ndër to 1 teke, 5 janë dhoma me nga dy shtretër, 6 dhoma me 4 shtretër dhe 1 dhomë është me 6 shtretër. Dushet dhe tualetet janë të pozicionuara në të dyja katet e strukturës, ku në zonën jugore të ndërtesës për të dyja katet është bërë shtesa e re prej 63.27 m².

Strukturat spitalore komunikojnë përmes një rruge të re të ndërtuar që akseson godinat për shërbimet e nevojshme spitalore.

Struktura e Shtëpisë së Mbrojtur Burra është një godinë e re e ndërtuar nga themelet prej dy katesh dhe me kapacitet 60 shtretër. Ka një sipërfaqe prej 642.42 m², 717 m² trotuare, 274 ml bordure si dhe 125 m² mbjellje bari.

Në katin 1 të godinës ndodhet recepsioni, 1 dhomë për një person, 1 dhomë ergoterapi, 1 dhomë mjeku, 1 dhomë infermieri, 1 dhomë kryeinfermieri, 1 dhomë stafi psikosocial, 1 dhomë ndenje pacientësh, 1 sallë ngrënieje, 1 magazinë dhe 1 dhomë përgjegjës materiali. Gjithashtu, po në këtë kat janë edhe 5 dhoma pacientësh me nga 2 shtretër.

Kati i dytë ndodhet 1 dhomë infermieri, 12 dhoma me nga 2 shtretër, 8 dhoma me 3 shtretër dhe 2 dhoma me 3 shtretër. Dhomat e pacientëve janë të projektuara kryesisht me tualetet brenda dhomave dhe për të tjerat kryesisht ato me 3 shtretër janë në tualetet e përbashkëta. Ka dy blloqe për dushet dhe tualetet e përbashkëta.

Mobilimi i brendshëm i të dy shtëpive të mbrojtura ka përfshirë ambientet e përbashkëta (sallë ndenjeje, sallë ngrënieje si dhe ergoterapitë), dhomat e personelit mjekësor e psiko-social si dhe dhomat e pacientëve. Të gjitha ambientet janë të pajisura me sistem kondicionimi dhe ajrimi si dhe sistemin e mbrojtjes nga zjarri. Në

të dyja strukturat në zonën veriore janë pozicionuar daljet në shkallët e emergjencës. Të dyja strukturat pjesë e investimit janë të pajisura me sistem monitorimi kamerash duke përjashtuar ambientet private si dhomat dhe tualetet.

Risia ndërtimore e strukturave spitalore për shërbim të shëndetit mendor konsistojnë në:

- Shtimi i shërbimeve si ergoterapi, psikoterapi, terapi psikosociale të cilat do të ndikojnë në rehabilitimin dhe integrimin e të sëmurit mendor.
- Ambiente krijuese dhe rehabilituese.
- Shtimin e ambienteve të gjelbëruara.
- Krijimin e ambienteve bashkëkohore në përputhje me respektimin e të drejtave të pacientit sipas standardeve evropiane.
- Dhomat e pacientëve të mobiluar sipas standardeve më të mira të mobilimit duke ulur edhe numrin e qëndrimit në një dhomë falë shtimit të sipërfaqeve të brendshme ndërtimore.

Spitali Psikiatrik Vlorë sipas rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit për plotësimin e nevojave e përmbushjen me cilësi e shpejtësi të shërbimeve janë pajisur të gjitha strukturat ku ofrohet shërbime për shëndetin mendor me pajisje mjekësore: autoklava për mikrokirurgjinë, dentistin dhe berberin, centrifugë dhe urinometër për laboratorin, material, instrumenta për dentistin dhe frigoriferë.

Pajisja me krevatë spitalorë 12 copë si dhe krevate vizitash 5 copë, karrige me rrota manuale 6 copë, karroca për medikamente 6 copë si dhe stativa 10 copë.

Përgjatë inspektimit konstatuam se spitali ka kryer procedurën e prokurimit për televizorë të cilat ishin shpërndarë në pavione.

Mobilimi i shtëpizave të mbrojtura është bërë në bazë të kërkesave të marra nga stafi multidisciplinar, gjithashtu për të kompletuar hapësirat e tjera që përdoren nga stafi shëndetësor si dhe stafi mbështetës është shfrytëzuar fondi i Marrëveshjes Kuadër për Mobilim të bazuar në nevoja.

Struktura dhe organika e institucionit e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me Urdhër nr.140, Datë 28.02.2022 për “*Miratimin e Organikës së Spitalit Psikiatrik Vlorë*” ishte e përbërë nga 128 punonjës¹, prej të cilëve 95 punonjës të ekipit multidisciplinar në përbërje: Mjek Psikiatër 7, Mjek Stomatolog 1, Farmacist 1, Laborante 1, Psikolog 5, Punonjës Social 8, Infermier 42, Kujdestar 30.

Gjithashtu u informuam se përmes VKM Nr. 19, datë 9.1.2025 për Spitalin Psikiatrik Vlorë janë shtuar në organikë 7 infermierë dhe 5 kujdestarë.

Ndërkohë infrastruktura e re e spitalit mundësonte kushte dinjitoze trajtimi për çdo person me probleme të shëndetit mendor që paraqitej në urgjencën e spitalit dhe vizitat mjekësore kryheshin konform ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, të ndryshuar. Ambientet, kushtet materiale, hapësira jetike për pacientët, si dhe shërbimi që ofrohej në pavijonin e pranimi, urgjencës dhe ato akut dhe sub-akut për gra dhe burra ishin në përputhje me standardet.

Sistemi i ankimit ishte në funksion jo vetëm për pacientët, por edhe në rastin e kërkesave/ankesave nga grupe interesi si p.sh., shoqata apo grupime të tjera vullnetare të pacientëve, familjarë ose persona të interesuar për mbrojtjen e interesave të personave me çrregullime të shëndetit mendor. Pasi njiheshin me kërkesë/ankesën personi i ngarkuar i spitalit mblidhte të gjithë informacionin e nevojshëm (kartela, shtrime, observacione), dhe më pas gjykonte nga ana mjekësore duke u konsultuar me stafin mjekësor kthente përgjigjen që në shumicën e rasteve nënkuptonte zgjidhjen e këtij pretendimi. Drejtuesit e institucionit na informuan se ata i ndiqnin dhe më tej rastet e kërkesë/ankesave pas kthimit të përgjigjes në rrugë zyrtare, stafi i spitalit kontaktonte në telefon me personat përgjegjës për t’i sqaruar dhe më tej.

Nga inspektimi në vend, u konstatua se rekomandimet e bëra nga Avokati i Popullit, sa i përket përmirësimit të kushteve të jetesës në pavijonet ku mbaheshin të sëmurët

¹ Sipas Urdhrit me nr. 140, datë 28.02.2022 “Për miratimin e organikës së Spitalit Psikiatrik Vlorë” të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

kronikë, nuk kishin gjetur zbatim tërësisht, për mungesë të akordimit të fondeve për këtë qëllim nga autoritetet përkatëse.

Nga informacioni, rezultoi se kishin gjetur zbatim rekomandimet e Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm²:

- ✓ Ishin marrë masat pjesërisht për t'i dhënë zgjidhje problemit të trajtimit si rezidentë të personave me aftësi të kufizuar intelektuale në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.
- ✓ Ishin marrë masat për pajisjen e institucionit me autoklavë për dentistin e institucionit si dhe me aerosterilizues për mikrokirurgjinë.

Ndërkohë, nuk kishte gjetur zbatim rekomandimi konkretisht:

- Për trajnimin e stafëve mbështetëse për përdorimin e mjeteve fizik konform standardeve të parashikuara në paketën e Akteve Nënligjore të ligjit Nr. 44/2012 "Për Shëndetin Mendor", dhjetor 2013 pika 1.1. si dhe përmirësimin e kushteve aktuale për izolimin e pacientëve me kriza akute.

Lidhur me çështjen të ngritur në mënyrë të vazhdueshme nga Avokati i Popullit të trajtimit si rezidentë të personave me aftësi të kufizuar intelektuale në kundërshtim me legjislacionin në fuqi (aktualisht në këtë spital ndodhen 103 pacientë të kësaj kategorie).

Përgjatë inspektimit u informuam nga stafi drejtues i spitalit se referuar, Urdhrit nr.547 datë 24.10.2024 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "*Për ngritjen e grupeve rajonale të punës për zbatimin e vlerësimit të detajuar të nevojave socio-shëndetësore dhe mundësive të akomodimit e të mbështetjes në komunitet të pacientëve rezidentë kronikë të Spitaleve psikiatrikë*" është ngritur një grup pune për vlerësimin e

² RekomandimNr.K4/I16-2 Prot, dat. 07.06.2024, Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të pacientëve në Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë.

çdo pacienti rezident kronik dhe gjetjen e mundësive të akomodimit dhe mbështetjes në komunitet (strukturat publike dhe jopublike).

Ligji për shëndetin mendor, në nenin 31 të tij, përcakton procedurat e monitorimit të jashtëm të shërbimit të shëndetit mendor nga Avokati i Popullit, nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin Çnjerëzor dhe Poshtërues, që vepron si strukturë e veçantë nën autoritetin e tij. Ligji garanton vëzhgimin e rregullt me anë të inspektimeve periodike, për të respektuar të drejtat dhe standardet që u ofrohen personave me çrregullime të shëndetit mendor në mjediset e shërbimit të shëndetit mendor të specializuar me shtretër, si dhe paraqet rekomandime në organet përkatëse, me qëllim përmirësimin e trajtimit dhe kushteve të pacientëve dhe sigurimin e respektimit të plotë të të drejtave të njeriut në institucionet e kujdesit të shëndetit mendor.

Konteksti dhe kuadri ligjor e institucional

Shërbimi shëndetësor në Shqipëri është rregulluar me ligjin nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili përcakton parimet kryesore dhe kuadrin ligjor për rregullimin, organizimin dhe funksionimin e sistemit të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë. Ndërkohë që shërbimi i shëndetit mendor në Shqipëri është rregulluar me ligj të posaçëm që në vitin 1996, përkatësisht me ligjin nr. 8092, datë 21.03.1996, “Për shëndetin mendor”, i cili më pas u shfuqizua me ligjin nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”, i ndryshuar, që synonte përmirësimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e kësaj kategorie. Ky ligj solli nevojën e reformave në lidhje me ngritjen dhe zhvillimin në shkallë kombëtare të kujdesit komunitar të shëndetit mendor si e vetmja mënyrë për të arritur shërbime komunitare të shëndetit mendor për të gjithë (përfshi deinstitutionalizimin të personave që vuajnë sëmundje të shëndetit mendor, monitorimin e të drejtave dhe lirive themelore nga mekanizma të jashtëm, pjesëmarrjen aktive të aktorëve të shoqërisë civile, etj.).

Në konceptin e gjithë përfshirjes, kuadri ligjor dhe institucional ofron mundësinë e një sistemi të integruar të shërbimeve të shëndetit mendor, i cili nënkupton një rrjet shërbimesh në nivel rajonal. Gjithsesi mbetet edhe shumë për të bërë në lidhje me

ofrimin e shërbimeve në nivel komuniteti dhe të programeve të ndihmës sociale për të ndihmuar familjet e personave dhe shtetasve që kanë probleme të shëndetit mendor.

Kushtet materiale dhe trajtimi i pacientëve.

Godina e spitalit të ri është ndërtuar në vitin 2015, me gjithë infrastrukturën e brendshme të rikonstruktuar me sistem të monitorimit me 14 kamera të cilat kishin afat ruajtje të pamjeve 30 ditor, si dhe sistemi qendror i ngrohjes/ftohjes, i cili ishte në funksion të plotë. Gjithashtu sjellim në vëmendje se dushet ishin funksionale në Pavijonin e Pranim-Urgjencës.

Në pavijonet e pacientëve me çrregullime kronike ishin rikonstruktuar të dyja godinat e pavijoneve të kronikëve burra dhe gra.

Numri i Pacientëve në Spitalin “Ali Mihali” Vlorë në ditën e inspektimit ishte 164 pacientë, nga të cilët : 40 në shtëpizën e mbrojtur Burra, 57 në shtëpizën e mbrojtur Gra , 21 pacientë Akut, Pranim Urgjenca 46.

Gjithashtu referuar verifikimit të regjistrave numri i shtrimeve në spital nga muaji janar deri prill janë gjithsej 110 pacientë.

Pavijoni i Pranim-Urgjencës dhe Pavijoni Akut –Sub-Akut (Burra-Gra), përbëhej nga 43 dhoma banimi dhe 9 dhoma pranim- urgjenca. Këto dhoma kishin kapacitet për mbajtjen 1 deri në 3 pacientë, këto dhoma ishin të pajisura me shtretër të pajisur me materialet e buta të nevojshme. Tualetet ishin të vendosura brenda dhomave dhe paraqiteshin në gjendje të mirë të lyera rishtazi dhe të pastra. Ndërkohë këndet e ndenjes në çdo pavijon ishin pajisur me televizorë.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatuam se furnizimi i fundit me materiale të buta ishte kryer në datën 18.04.2025 me:

-Dyshekë - 100 copë.

-Këllëf jastëku- 800 copë.

- Çarçafë -800 copë.
- Batanije -200 copë.
- Peshqirë -250 copë.
- Pizhame grash-200 copë.
- Pizhame burrash -200 copë.
- Peshqirë duarsh 600 copë.

Shtrimet e pavullnetshme kryheshin në përputhje me nenin 20 të ligjit Nr. 44/2012, “Për Shëndetin Mendor” të ndryshuar. Për vitin 2025 në regjistrin e kufizimeve fizike ishin pasqyruar procedurat e ndjekura sipas protokollit për 7 pacientë me afatin kohor të kufizimit 20 minuta. Ndërkohë nga stafi mjekësor ishin trajtuar dhe ndjekur 4 shtrime të pavullnetshme.

Sa më sipër Avokati i Popullit sjell në vëmendje trajnimin e përshtatshëm fillestar dhe të vazhdueshëm të stafit të përfshirë në kufizimin e pacientëve, dhe promovimin e zhvillimit të masave alternative (duke përfshirë teknikat e uljes së përshkallëzimit të situatës.

KPT-ja³, rekomandon se mund të përdoren një ose më shumë nga llojet e mëposhtme të kufizimit⁴:

- (a) kufizimi fizik (p.sh. personeli që e mban ose e çmobilizon një pacient duke përdorur forcën fizike - "kontrolli manual");
- (b) kufizimi mekanik (p.sh. përdorimi i instrumenteve të kufizimit, të tilla si mjetet lidhëse, për të çmobilizuar pacientin);
- (c) kufizimi kimik (d.m.th. administrimi me forcë i medikamenteve me qëllim të kontrolluarin e sjelljes së pacientit);
- (d) izolimi (d.m.th. vendosja e pavullnetshme e një pacienti vetëm në një dhomë të mbyllur).

³ Këshilli i Evropës Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruar (KPT) Strasburg, 21 Mars 2017 CPT/Inf (2017). Mjetet e kufizimit në institucionet psikiatrike për të rriturit për (standardet e rishikuara të KPT-së).

⁴ <https://rm.coe.int/1680782465>.

Ndalimi i pacientëve të dhunshëm psikiatrik që paraqesin rrezik për veten ose të tjerët mund të jetë jashtëzakonisht i nevojshëm.

Mjetet e kufizimit duhet gjithmonë të zbatohen në përputhje me parimet e ligjshmërisë, domosdoshmërisë, proporcionalitetit dhe llogaridhënies.

Të gjitha llojet e kufizimeve dhe kriteret për përdorimin e tyre duhet të rregullohen me ligj.

Pacientët duhet të kufizohen vetëm si masë fundore për të parandaluar dëmtimin e menjëhershëm ndaj vetes, ose të tjerëve.

Kufizimet duhet të përdoren gjithmonë për kohën më të shkurtër të mundshme. Kur pushon së ekzistuari situata urgjente që çon në përdorimin e kufizimit, pacienti duhet të lirohet menjëherë.

Mjetet e kufizimit janë masa sigurie dhe nuk kanë justifikim terapeutik. Mjetet e kufizimit nuk duhet të përdoren kurrë si dënim, ose thjeshtë për lehtësimin e stafit, për shkak të mungesës së stafit, ose për të zëvendësuar kujdesin, ose trajtimin e duhur.

Çdo institucion psikiatrik duhet të ketë një politikë gjithëpërfshirëse dhe të zhvilluar me kujdes kufizimin, referuar nenit 27 të Rekomandimit Rec (2004) nr.10 të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe dinjitetin e personave me çrregullime mendore, si dhe vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen Bus kundër Republikës Çeke (18 tetor 2012, çështja nr. 37679/08, paragrafi 86) dhe MS kundër Kroacisë (19 shkurt 2015, çështja nr.7754 / 12, paragrafi 97. Këto politika duhet të synojnë parandalimin sa më shumë që të jetë e mundur të përdorimit të mjeteve të kufizimit dhe duhet të bëjnë të qartë se cilat mjete kufizimi mund të përdoren, në çfarë rrethanash mund të përdoren ato, mënyrën e përdorimit të tyre, mbikëqyrjen e nevojshme, dhe masat që do të merret pas ndërprerjes së masës.

Politika duhet të përmbajë edhe seksione për çështje të tjera të rëndësishme, siç janë: trajnimi i stafit, regjistrimi, mekanizmat e raportimit të brendshëm dhe të jashtëm, raportimet, dhe procedurat e ankimit. Për më tepër, pacientëve u duhet dhënë informacioni përkatës mbi politikat e kufizimit të përdorura nga institucioni. Autorizimi për çdo ushtrim të masave të kufizimit, gjithmonë duhet miratuar nga mjeku pas një vlerësimi individual, ose duhet t'i silllet menjëherë në vëmendje mjekut me qëllim marrjen e miratimit prej tij. Për këtë qëllim, mjeku duhet ta vizitojë pacientin në fjalë sa më shpejt të jetë e mundur.

Përdorimi i mjeteve të kufizimit:

Masat e kufizimit duhet të zbatohen gjithmonë me aftësi dhe kujdes, në mënyrë që të zvogëlohet rreziku i lëndimit ose shkaktimit të dhimbjes ndaj pacientit dhe të ruhet dinjiteti i tij sa më shumë të jetë e mundur.

Stafi duhet të ketë formimin e duhur para se të marrë pjesë në zbatimin praktik të masave të kufizimit.

Kur nevojitet përdorimi i kufizimit fizik (manual), stafi duhet të jetë i trajnuar posaçërisht për teknikat e kufizimit që zvogëlojnë rrezikun e lëndimit.

Duhet të ndalohet mbajtja nga qafa dhe teknikat që mund të pengojnë rrugët e frymëmarrjes së pacientëve, ose që shkaktojnë dhimbje për ta.

Për qëllimet e kufizimit mekanik, duhen të përdoren vetëm ato pajisje që janë të projektuara për të kufizuar pasojat e dëmshme (preferohen rripat e veshur të kufizimit fizik) në mënyrë që të zvogëlohet rreziku që pacienti të lëndohet dhe/ose të ndiejë dhimbje.

Prangat apo zinxhirët nuk duhet të përdoren kurrë për ta çmobilizuar pacientin.

Pacientët nën kufizim duhet të jenë gjithmonë me fytyrën lart dhe me krahët e shtrirë poshtë. Rripat nuk duhet të jenë shumë të ngushtë dhe duhen përdorur në mënyrë të

tillë që të lejojnë lëvizje sa më të lirshme dhe të sigurt të gjymtyrëve. Funkcionet jetike të pacientit, të tilla si frymëmarrja apo aftësia e komunikimit, nuk duhen penguar. Pacientët nën mjete kufizuese duhen të kenë veshjen e duhur dhe, sa më shumë të jetë e mundur, të lejohen të hanë dhe pinë vetë dhe t'i përmbushin nevojat personale në një ambient higjienik.

Stafi nuk duhet të ndihmohet nga pacientë të tjerë kur zbaton masat e kufizimit mbi pacientin.

Kur nevojitet kufizimi kimik, duhen përdorur vetëm medikamente të miratuara dhe me efekte afatshkurtra. Duhet pasur parasysh dhe efektet anësore që mund të ketë mjekimi mbi një pacientë të caktuar, sidomos kur mjekimi shoqërohet me kufizim mekanik, ose izolim.

Për sa i përket izolimit, dhoma ku vendosen pacientët duhet të jetë e posaçme për këtë qëllim. Në veçanti, ambienti duhet të garantojë sigurinë e pacientit të kufizuar dhe të ofrojë një ambient qetësues për të.

Ushtrimi i masave të kufizimit mekanik dhe izolimit duhet të bëhet për një kohë sa më të shkurtër të mundshme (**zakonisht në minuta, jo orë**), dhe gjithmonë duhet të përfundojë në çastin e përfundimit të shkaqeve të kufizimit. Zbatimi i kufizimit mekanik për ditë të tëra nuk mund të ketë asnjë justifikim dhe, sipas Komitetit për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtërues (KPT), mund të çojë në keqtrajtim.

Regjistrimi dhe raportimi i rasteve të mjeteve të kufizimit (regjistri):

Përvoja ka treguar se regjistrimi i hollësishëm dhe i saktë i rasteve të kufizimit mund t'u sigurojë strukturave drejtuese të spitalit një vështrim të përgjithshëm të nivelit të shfaqjes së tyre dhe mundëson marrjen e masave, aty ku është e përshtatshme, për të ulur incidencën e tyre. Për këtë qëllim, duhet të krijohet një regjistër specifik për të regjistruar të gjitha rastet e përdorimit të mjeteve të kufizimit (duke përfshirë kufizimet

kimike). Ai duhet të jetë plotësues i të dhënave që përmban dosja mjekësore personale e pacientit. Shënimet në regjistër duhet të përfshijnë kohën kur ka filluar dhe përfunduar masa, rrethanat e rastit, arsyet pse është përdorur masa, emrin e mjekut që e ka urdhëruar ose miratuar atë, dhe një pasqyrim të çdo dëmtimi të pacientëve, ose të stafit. Pacientët duhet të kenë të drejtë të bashkëngjisin komente në regjistër dhe duhet të informohen për këtë të drejtë.

- Dhoma e izolimit në spitalin Psikiatrik Vlorë është rikonstruktuar në vitin 2022 dhe është brenda të gjitha standardeve të kërkuara nga ligji për shëndetin mendor.
- Ushqimi sigurohej me katering nga shërbimi privat i kuzhinës. Kuzhinierët dhe punonjësit që shpërndanin ushqimin, ishin të pajisur me librezën shëndetësore të higjienës. Kampionët ushqimorë ruheshin sipas rregullave në frigorifer konstatuar kjo në momentin e inspektimit. Ushqimi ishte cilësor dhe nuk kishte raste të refuzimit të tij⁵. Ushqimi konsumohej në ambientin e mensës. U konstatua se këto ambiente ishin të pajisura me tavolina, stola apo karrige, të përshtatshme me numrin e personave në pavijonet përkatëse. Mbështetur në urdhrin nr. 72 më dt. 07.02.2024, me nr. Prot 756, dieta ushqimore për të sëmurët është e përcaktuar nga Urdhri i Ministrisë së Shëndetësisë për kalorazhin ditor për të sëmurët psikiatrik, dieta nr.14 (3000 kalori ndër të cilat prot, 122gr, lip 180gr, gluc 385 gr).
- Spitali ishte pajisur rishtazi me rripa të kufizimit fizik dhe këmisha force si një domosdoshmëri për trajtimin me dinjitet të pacientëve, **megjithatë ka nevojë që të organizohen trajnime të posaçme për mënyrën e përdorimit të tyre nga stafi mjekësor në rastet e nevojshme.**
- Furnizimi me ujë ishte pa probleme dhe plotësonte nevojat e përditshme
- 2 autoambulancat në institucion paraqiteshin në gjendje jo të mirë dhe për nevoja të spitalit nevojitet ndërhyrja në riparimin e tyre si dhe shtimi me një autoambulancë.

⁵ Personat me çrregullime të shëndetit mendor gëzojnë të drejtën për t'u siguruar kushtet e përshtatshme jetësore, higjienike, të ushqyerjes dhe sigurisë, në përputhje me nenin 6, pika 1, gërma g) të Ligjit nr. 44/2012. Në përputhje me standardet e përcaktuara nga KPT "Ushqimi duhet të jetë jo vetëm i përshtatshëm nga pikëpamjet e sasisë dhe cilësisë, por edhe t'ju serviret pacientëve në kushte të kënaqshme".

- Organika e shërbimit psiko-social ishte e plotësuar. Kishte një mirë organizim dhe ndarje të punës ndërmjet punonjësve, si dhe një bashkëpunim e bashkërendim të mirë me stafin mjekësor, konstatuar nga intervistat e kryera me disa prej këtyre punonjësve.
- Ambientet e përbashkëta, për zhvillimin e aktiviteteve apo terapive në grup nga ana e stafit psiko-social, ishin të bollshme, të rregullta dhe në përgjithësi të mirëmbajtura megjithëse konstatohen disa dëmtime të shkaktuara gjatë përdorimit. Punonjësit e shërbimit psiko-social punonin mbi bazën e një plani fillestar që në shtrim dhe më pas pacientët ndiqeshin me këshillime individuale e në grup, psiko-edukim dhe në fund kishte një plan daljeje për secilin prej tyre. Ndërsa sa i përket pacientëve kronikë shërbimi i këtij stafi përqendrohej në rehabilitimin e tyre, duke punuar me plane individuale si dhe bëheshin përpjekje për t'i përgatitur që të transferoheshin në shtëpizat e mbështetura e në raste shumë të rralla në shtëpi. Kjo procedurë kryhej me vendimmarrje të mjekut kurues dhe shefit të pavijonit. Stafi i institucionit na bëri me dije se ishin zhvilluar aktivitete të dendura në ndërveprim me të sëmurët në kuadër të rehabilitimit dhe aftësimi social. *KPT ka rekomanduar se trajtimi psikiatrik duhet të jetë i bazuar në një plan trajtimi individual. Duhet të përfshijë një gamë të gjerë aktiviteteve rehabilituese dhe terapeutike, duke përfshirë qasjen në terapi profesionale, terapi grupore, psikoterapi individuale, art, dramë, muzikë dhe sport. Pacientët duhet të kenë qasje të rregullt në dhomat e rekreacionit të pajisura në mënyrë të përshtatshme dhe të kenë mundësinë të realizojnë ushtrime në natyrë në baza ditore; është gjithashtu e dëshirueshme që atyre t'u ofrohet arsimim dhe punë e përshtatshme⁶.*
- Kabineti stomatologjik dhe i mikrokirurgjisë ishin pajisur me autoklavë dhe aerosterilizues.
- Farmacia ishte e pajisur me medikamentet e nevojshme dhe nuk kishte mungesa, nga verifikimi i medikamenteve nuk rezultoi se kishte ndonjë titull jashtë afateve të përdorimit.
- Nga verifikimi i bërë rezultoi se regjistrat e të gjithë pavijoneve dhe procedurave të shtrimeve që kryhen në këtë spital ishin të sekretuar dhe të mbajtur me rregull,

⁶ 6CPT/Inf/E (2002) 1 - Rev. 2011, parag. 37.

regjistri i pranimit, i konsultave, dhe ai i shtrimeve të pavullnetshme. Të mbajtura me rregull dhe të pasqyruara saktë ishin edhe regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve.

- Ky spital kishte të ngritur sistemin elektronik për çdo pacient dhe diagnozat e tyre si dhe zyrën e informacionit me personel të mjaftueshëm.
- Nga këqyrja e të gjitha ambienteve konstatojmë se nevojitet krijimi i një fushe sportive për zhvillimin e aktiviteteve sportive në natyrë.
- Në spitalin Psikiatrik Vlorë ishte kryer Dezinfektimi 3D nëpërmjet kontratës Nr.680, Datë 21.03.2025 “Për Dezinfektimin, Deratizimin, Dezinfektimin e Ambienteve”.
- Nëpërmjet kontratës nr. 228/4 datë 25.02.2025 Spitali Psikiatrik kishte nënshkruar kontratë me shoqërinë “Medi-Tel” për grumbullimin dhe përpunimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore.
- Nga kontrolli i të gjithë dokumentacionit lidhur me trajtimin e pacientëve nuk u konstatua ndonjë rast kur mund të kishte mbidozim me medikamente, çdo trajtim kishte një protokoll të qartë trajtimi.
- Takimet me familjarët kryheshin në ambientet të brendshme të spitalit në çdo kohë dhe pa limit.

Ndërkohë referuar nenit 6, ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, i ndryshuar në të gjitha ambientet ishin **afishuar të drejtat e pacientëve si më poshtë:**

- a) të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm kushtetues;
- b) të drejtën të marrin shërbim shëndetësor të arritshëm dhe efikas në kushte të barabarta si të gjithë pacientët e tjerë;
- c) të drejtën për trajtim dhe mbrojtje, bazuar në respekt të individualitetit dhe dinjitetit të tyre;
- ç) të drejtën për të pranuar ose jo ndërhyrjen e propozuar diagnostike e terapeutike, përveç rasteve të tjera të parashikuara në këtë ligj;

d) të drejtën për të marrë informacionin e duhur për të drejtat e tyre, si dhe për të qenë pjesë e hartimit të planit individual të trajtimit;

dh) të drejtën për të kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga gabimi në trajtim ose keqtrajtimet e mundshme;

e) të drejtën për të kërkuar rishqyrtimin e shtrimit apo mjekimit të detyruar;

ë) të drejtën për konfidencialitet mbi të dhënat, për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore;

f) të drejtën për të mos u detyruar forcërisht të ekzaminohen nga pikëpamja mjekësore, me qëllim përcaktimin e një çrregullimi të shëndetit mendor të mundshëm, me përjashtim të rasteve dhe sipas procedurës së përshkruar në këtë ligj;

g) të drejtën për t'u siguruar kushtet e përshtatshme jetësore, higjienike, të ushqyerjes dhe sigurisë; gj) të drejtën për t'u ankuar për ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor.

Ushtrimi i të drejtave të personave me çrregullime të shëndetit mendor mund të kufizohet vetëm në rastet e parashikuara ligjin nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, i ndryshuar. Këto kufizime janë në përpjesëtim me gjendjen e diktuar shëndetësore dhe nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të drejtave.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*, si dhe të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.*

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave për informimin e Avokatit të Popullit në vazhdimësi, lidhur me zbatimin e Urdhrit nr.547 dat 24.10.2024 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale *“Për ngritjen e grupeve rajonale të punës për zbatimin e vlerësimit të detajuar të nevojave socio-shëndetësore dhe mundësive të akomodimit e të mbështetjes në komunitet të pacientëve rezidentë kronikë të Spitaleve psikiatrikë”*.
2. Marrjen e masave për trajnimin e stafeve mbështetëse për përdorimin e mjeteve të kufizimit fizik konform standardeve të parashikuara në paketën e Akteve Nënligjore të ligjit Nr. 44/2012 ”Për Shëndetin Mendor”, i ndryshuar pika 1.1. si dhe përmirësimin e kushteve aktuale për izolimin e pacientëve me kriza akute.
3. Marrjen e masave për shfrytëzimin e hapësirave të jashtme të spitalit duke krijuar ambiente sportive dhe miqësore për pacientët e akomoduar në Spitalin Psikiatrik Vlorë.
4. Marrjen e masave për pajisjen e Spitalit Psikiatrik Vlorë me Autoambulancë të re si dhe sigurimin e mirëmbajtjes teknike të 2 Autoambulancave ekzistuese.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihem në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)
Ahmet PRENÇI
d.v

